

VENDIMI ËSHYË I PLOTFUQISHËM
DOKUMENTI I DOKUMENTI I DOKUMENTI I
KARAR KESINDIR
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD / ASLIE MAHKEMESI
PRIZREN II PRIZREN - PRIZRENE
17.03.2017

P.nr.102/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda
kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në
çështjen penale kundër të akuzuarve J . J nga fsh.. Komuna e
, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërnadarja dhe shitja e
paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.2 të KP,
dhe veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve supstancave psikotrope ose
analoge nga neni 275 par.1. të KP, dhe M J nga fsh. Komuna
e . për shkak të veprës penale dhënja e ndihmës në kryerjen e veprës penale
blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave
psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me nenin 33 të KP, duke vendosur
sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda,
PP.nr.318/15 të datës 23.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë në prezencën e
Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre avokat H
M , M S dhe A . B , me datën 01.12.2016, muarr dhe publikisht e shpalli
këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari

J J , nga i ati V dhe e ëma S . – e lindur M , i
lindur më në fshatin Komuna e , ku edhe tani
jeton, i martuar – i ati i tre fëmijëve, me profesion agjuntator, e ka të kryer shkollën e
mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka
qenë në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 20.11.2015 gjerë më 13.09.2016.

M J , nga i ati R dhe e ëma M – e lindur , i
lindur më në fshatin Komuna e , ku edhe tani
jeton, i martuar – i ati i katër fëmijëve, me profesion bujk, ka të kryer shkollën e mesme, i
gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në
paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 20.11.2015 gjerë më 13.09.2016.



JANË FAJTOR

I akuzuari J . J :

1. Më datën 20. nëntor. 2015 rrethë orës 21:00, në vendkalimin e autorizur kufitar në Komuna e , pa autorizim transporton supstanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, në atë mënyrë që paraprakisht në punëtorinë e tij në fshatin Shqipëri dhe nga atje të transportoi substancë narkotike deri në punëtorinë e tij në , se për këtë do të marrë shpërblim shumë prej 1000 Euro, mirret vesh me të akuzuarin M Ja që ti ndihmoi rrethë drejtimit të automjetit dhe nisen për në Shqipëri, kur arrinë në Shqipëri, në rezervarin e automjetit të tipit "Rang Rover" me targa rregjistrimi , ngarkon 30 paketime me qese plastike të tejdukshme me substancë narkotike të llojit "marihuanë" në peshë të përgjithëshme prej 16 kilogram, nisen për në Kosovë dhe gjatë kontrollit të kryer nga ana e policisë në automjetin e lartëcekur të cilin ishte duke e drejtuar i akuzuari M. J , në momentin kur ishin duke kaluar pikën kufitare nga Republika e Shqipërisë për Republikën e Kosovës, zbulohet nga ana e Policisë kufitare, e pikërisht policia në rezervuarin e këtij automjeti i gjenë të fshehura këto paketime me substancë narkotike, e të cilën substancë narkotike e ka patur për qëllim që ta shpërndajë në fshatin i te personi identitetin e të cilit nuk e tregon, substancë kjo e ndaluar sipas Ligjit për barënat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor


-Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KP/

2. Se deri më datën 21.11.2015 i akuzuari pa autorizim ka poseduar narkotik të llojit "marihuanë" në peshë të përgjithëshme prej 500 gram, e të cilin narkotikë policia e ka gjetur gjatë bastisjes me urdhër të gjykatës në shtëpinë e tij, substancë kjo e ndaluar sipas Ligjit për barënat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor

-Këso dore ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1. i KP.

I akuzuari M . J :

1. Më datën 20.11.2015 rrethë orës 21:00, në vendkalimin e autorizuar kufitar në Komuna e , i ndihmon të akuzuarin M. J që pa autorizim të transporton supstanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të



shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, që ti ndihmoi rrethë drejtimit të automjetit rrugës për të shkuar në Shqipëri dhe për tu kthyer nga Shqipëria, kështu nisen për në Shqipëri, me automjetin e tipit "Rang Rover" me targa rregjistrimi - - - dhe ndihmon në transportimin e substancës narkotike të llojit "marihuanë", me peshë të përgjithëshme prej 16 kilogram ashtuqë gjatë kthimit për në Kosovë në pikën kufitare të rezervuarin e automjetit e të cilin e ka drejtuar këtu i akuzuari M. J., supstancë kjo e ndaluar sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor

-Këso dore ka kryer veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, ose shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me nenin 33 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 7, 17, 33, 41, 45, 46, 62, par.2.pika 2.6, 73, 74, 80, 83, në lidhje me nenin 273 par.2, 275 par.1. dhe 273 par.2. lidhur me nenin 33 të KP, i

G J Y K O N

Të akuzuarin J. J. :


Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KP me dënim me gjobë në shumën prej 2000 Eurove si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tri/ viteve.

Për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, supstancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1. i KP me dënim me gjobë në shumën prej 200 /dyqindë/ Euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 80 par.2. pika 2.2. dhe 2.4, të KP ia shqipton dënimin unik me gjobë në shumën prej 2200 /dymijëedyqindë/ Euro si dhe dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tri/ viteve, në të cilin dënim me burgim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 20.11.2015 deri më datën 13.09.2016.

Të akuzuarin M. J. :

Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me nenin 33 të KP me dënim me gjobë në shumën prej 800 /tetëqindë/ Euro si dhe me dënim me



burgim në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti e 10 /dhjetë/ muajve, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 20.11.2015 gjerë më datën 13.09.2016.

Obligohen të akuzuarit J. J. dhe M. J. që dënimin me gjobë ta paguajnë në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Poqese dënimin me gjobë nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë atëherë dënimin me gjobë do të iu zëvendësohet me dënim me burgim ashtuqë për çdo 20 Euro të dënimin me gjobë do ti shqiptohet një ditë burgim.

Nga i akuzuari J. J. konformë nenit 62 par.2.pika 2.6, të KP konfiskohet automjeti i markës "Rang Rover", me targa të rregjisimit - - si dhe 16 kilogram dhe 500 gram të supstancës narkotike të llojit "marihuanë" si mjete të kryerjes së veprës penale.


Obligohet i akuzuari J. J. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale – paushalit gjyqësor të paguajë shumën prej 200 Euro, ndërsa i akuzuari M. J. shumën prej 100 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP.nr.318/15 të datës 23.06.2016 kundër të akuzuarit J. J. dhe M. J. për shkak se si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale blerja, posedimi ose shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. lidhur me nenin 31 të KP, si dhe të akuzuarit J. J. për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, supstancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1. i KP.

Gjatë shqyrtimit të dytë Prokurorja e Shtetit e ka bërë rikualifikimin e veprave penale sa i përket dispozitivit nën I të aktakuzës, ashtuqë të akuzuarin J. J. e ka akuzuar për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KP. Poashtu e ka bërë edhe rikualifikimin e veprës penale sa i përket të akuzuarit J. J. të cilin pas ricijesimit të veprës penale e akuzon për veprën penale të dhënjes së ndihmës në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2.lidhur me nenin 33 të KP.

Ka propozuar që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata si rrethanë lehtësuese të marrë për bazë faktet se që të dy të akuzuarit kanë pranuar fajsinë



për të gjitha pikat e aktakuzës faktin se më herët nuk kanë qenë të dënuar, ndërsa si rrethanë rënduese të merr faktin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore të kësaj veprë penale dhe rritjen e numrit të këtyre veprave penale në rrethinën e Prizrenit.


Mbrojtësi i të akuzuarit J. J. avokat H. M. ka theksuar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e tij është bërë pranimi i fajsisë si vullnet i shprehur duke kuptuar rëndësinë, peshën dhe pasojën si dhe natyrën e veprës penale, për çka i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh benefitet ligjore të parapara nga ligjdhënësi, sidomos rrethanat lehtësuese të cilat posaqërisht janë në favor të të mbrojturit të tij dhe ti shqiptoi dënimin nën minimumin ligjor për veprat penale, sepse efektet si të preventivës ashtu edhe të represivës janë arritur tek i mbrojturi i tij. Njëjti është në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, ka dy muaj që është në asistencë sociale për çka edhe mund të vërtetohet në çdo kohë në Kuvendin komunal në Prizren, është mbajtës i familjes, prind i fëmijëve të vegjël, prandaj konsideron se dënimi më i ulët do të ketë efektet që mos të përsëritet si e tillë, e sidomos faktin se në të gjitha fazat e procedurës i njëjti e ka pranuar fajsinë, është penduar thellë duke shprehur keqardhje, është hera e parë që i njëjti ndeshet me ligjin dhe i premtun gjykatës se nuk do të përsëris vepra të këtilla të ngjajshme penale.

Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari duke cekur se është penduar për gabimin, se nuk do të përsëris një gabim të tillë apo ndonjë vepër që do të vie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ndien shumë keqardhje për gabimin që e ka bërë dhe se është mbajtës i vetëm i familjes 13 anëtarëshe.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. J. - avokat A. B. ka theksuar se i mbrojturi i tyre M. J. e ka pranuar fajsinë dhe ky pranim është edhe pendimi i tij, dhe se ky është argument i mjaftueshëm se e ka kuptuar gabimin dhe asnjëherë nuk do të vie në shprehje përsëritja. Është i bindur se edhe gjykata pranimin e fajsisë do ta vlerësoi mjaftueshëm dhe do ta konsideronte si rrethanë veçanërisht lehtësuese, konformë kësaj do ta shqiptonte një dënim me zbutje konformë nenit 76 par.1. nën par.1.4, e që edhe me një dënim të tillë mjaftueshëm do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Përveç rrethanës lehtësuese-pranimin e fajsisë, gjykata do të duhej të ketë parasysh edhe rrethanat e tjera lehtësuese, se është mbajtës i familjes, baba i katër fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike dhe sidomos që asnjëherë më parë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin.

Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari M. J. dhe ka theksuar se është i penduar për veprën e kryer dhe nuk do të përsëris më vepra të këtilla apo të ngjajshme.

Andaj, duke marr parasysh të lartëcekurat, si dhe pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarve, e që pranimi i fajsisë është bërë konformë nenit 248 të KPP, pasi që të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarëve pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuzën, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuar Jeton Jaholli të përshkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet qenësore të veprës blerja,




posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KP, pasi që më datën 20.nëntor.2015 rreth orës 21:00, në vendkalimin e autorizuar kufitar në Komuna e , pa autorizim transporton supstanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, në atë mënyrë që paraprakisht në punëtorinë e tij në fshatin pranon ofertë nga një person identitetin e të cilit nuk e tregon, për të shkuar deri në Shqipëri dhe nga atje të transportoi supstancë narkotike deri në punëtorinë e tij në , se për këtë do të marrë shpërblim shumë prej 1000 Euro, mirret vesh me të akuzuarin M. J që ti ndihmoi rreth drejtimit të automjetit dhe nisen për në Shqipëri, kur arrinë në Shqipëri, në rezervarin e automjetit të tipit "Rang Rover" me targa rregjistrimi , ngarkon 30 paketime me qese plastike të tejdukshme me supstancë narkotike të llojit "marihuanë" në peshë të përgjithëshme prej 16 kilogram, nisen për në Kosovë dhe gjatë kontrollit të kryer nga ana e policisë në automjetin e lartëcekur të cilin ishte duke e drejtuar i akuzuari M. J , në momentin kur ishin duke kaluar pikën kufitare nga Republika e Shqipërisë për Republikën e Kosovës, zbulohet nga ana e Policisë kufitare, e pikërisht policia në rezervuarin e këtij automjeti i gjenë të fshehura këto paketime me supstancë narkotike, e të cilën supstancë narkotike e ka patur për qëllim që ta shpërndajë në fshatin te personi identitetin e të cilit nuk e tregon.

Gjykata poshtu në bazë të pranimit ka vërtetuar se në veprimet e të njejtit formohen edhe elementet qenësore të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, supstancave psikologe ose analoge nga neni 275 par.1. të KP, pasi që deri më datën 21.11.2015 i akuzuari pa autorizim ka poseduar narkotik të llojit "marihuanë" në peshë të përgjithëshme prej 500 gram, e të cilin narkotikë policia e ka gjetur gjatë bastisjes me urdhër të gjykatës në shtëpinë e tij.

Andaj, duke marrë parasysh të lartëcekurat gjykata të akuzuarit Jeton Jaholli për secilën nga veprat e lartëcekura penale ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjyqimit, e pastaj me aplikimin e dispozitave për dënimin unik për të dy veprat e lartëcekura penale ia shqiptoi dënimin unik me gjobë në shumë prej 2200 Euro si dhe dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 viteve në të cilin dënim me burgim ia llogariti edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 20.11.2015 gjerë më 13.11.2016.

Poashtu, në bazë të pranimit të fajsisë gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit M. J formohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge, në ndihmë nga neni 273 par.2.lidhur me nenin 33 të KP, pasi që më datën 20.11.2015 rreth orës 21:00, në vendkalimin e autorizuar kufitar në Komuna e Prizrenit i ndihmon të akuzuarit J. J që pa autorizim të transporton supstanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, që ti ndihmoi rreth drejtimit të automjetit rrugës për të shkuar në Shqipëri dhe për tu kthyer nga Shqipëria, kështu nisen për në Shqipëri, me automjetin e tipit "Rang Rover" me targa rregjistrimi dhe ndihmon në transportimin e supstancës narkotike të llojit "marihuanë", me peshë të përgjithëshme prej 16 kilogram ashtu që gjatë kthimit për në Kosovë në pikën kufitare të Vermicës, zbulohet nga ana e



policisë kufitare me supstancë narkotike të fshehur në rezervuarin e automjetit e të cilin e ka drejtuar këtu i akuzuari M. J. , për çka edhe gjykata ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumën prej 800 Euro si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti e 10 muajëve, në të cilin dënim me burgim ia llogariti edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 20.11.2015 gjerë më 13.09.2016.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata ka marrë parasysh nenin 41 të KP,i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në rastin konkret dhe se prej rrethanave lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësië nga ana e të akuzuarve, qëndrimin korrekt të tyre në gjykatë,gjendjen e tyre ekonomike të vështirë, se janë të martuar dhe kanë fëmij,si dhe pendimin për veprat e kryera penale.Ndërsa prej rrethanave rënduese motivet nga të cilat është kryer vepra penale- motivi është përfitimi material,si dhe intenzitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasiqë kemi të bëjmë me supstanca narkotike me rrezikshmëri të lartë veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë sipas Ligjit për barënat narkotike,supstancat psikotrope dhe prekursor,sasine e supstancës narkotike, faktin se veprën penale e kanë kryer me dashje,duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e së njëjtës dhe rrezikshmërinë e saj për rininë,pasiqë përdorues kryesisht është rinia dhe se droga shkatëron familjen, shëmton vetëdijen, degjeneron individin dhe viktimizeon brezin e ri. Andaj, duke marrë parasysh këto fakte gjykata është e mendimit se me dënimet e këtilla të shqiptuara si në dispozitiv do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre,të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale,ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit me qëllim të luftimit të këtyre dukurive të shëmtuara shoqërore në mënyrë që të ndalet hovi i zhvillimit të tyre të mëtutjeshëm. Është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë dispozitës së lartëcekur,se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur,si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve tui mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale,si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën e kryer penale.Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në shërbim të preventivës së përgjithshme,posaqërisht të asaj të posaçme,se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë,përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e tij.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi konfiskimin e sasisë së supstancave narkotike dhe të automjetit është marrë konformë nenit 62 par.2.p.2.6. të KP në lidhje me nenin 39.1 të Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 453 par.1 të KPP.



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
Më datë 01.12.2016.P.nr.102/16

Proçesmbajtësja
Sheqere Braha

Kryetarja e trupit gjykues
Ajsër Skenderi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e paktënajur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite nga dita e pranimit – Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

